

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar i trupit gjykues, Luljeta Shabani dhe Islam Thaqi, anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Vahide Dërmaku, në çështjen penale ndaj të akuzuarës G. S., nga fshati K. i E., Komuna e R., të cilën sipas autorizimit e mbron avokati E. Q., nga Gj., për shkak të veprës penale dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin, nga neni 215 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,¹ sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.352/2013, e datës 30.12.2013, të cilën e përfaqësonte prokurori Afrim Shefkiu, pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore dhe publike, më datën 01.08.2014, mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

E akuzuara G. S., nga babai V. dhe nëna D., e lindur A., e lindur më ..., në fshatin K. i P., Komuna e R., ndërsa jeton në fshatin K. i E., serbe, qytetare e Republikës së Kosovës, e martuar, nënë e dy fëmijëve, punon si ... dhe ... e kontabilitetit në Qendren për Punë Sociale në R., e gjenjdes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, nuk ka qenë më parë e dënuar për ndonjë vepër tjetër penale,

Ë S H T Ë F A J T O R E

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Sepse më datën2013, rreth orës ..., në shtëpinë e saj në fshatin K. i E., Komuna e R., ka ofruar dhe dhënë të holla personit M. S., nga fshati P., në vlerë prej 5.000.00 dinar (pesëmijë dinar), që të ndikojë për të votuar për përfaqësuesin e subjektit politik “ ...”, përndryshe do ti ndalet ndihma sociale që janë duke marrë nga Republika e Serbisë dhe fëmijët do t’i ia lënë pa bukë, po qese deri me ... 2013, nuk e vërteton me dëshmitarë se ka votuar për këtë subjekt politik.

- me këtë ka kryer veprën penale dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin, nga neni 215 paragrafi 1 i KPRK.

Andaj, trupi gjykues në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73 dhe 74 të KPRK, si dhe nenit 365 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale,² të akuzuarës i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarës G. S., i caktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilin dënim e akuzuara nuk do ta mbajë, nëse në afat prej 1 (një) viti, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës prerë nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Nëse revokohet dënimi me kusht, atëherë në dënimin e shqiptuar me burgim, të akuzuarës G. S., do t’i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak, prej datës 10.12.2013 deri më datën 28.01.2014.

Obligohet e akuzuara G. S., që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 50 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas datës kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

ARSYETIMI

1. Ecuria e procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve

² Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP) nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, më datën 30.12.2013, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të akuzuarës G. S., nga fshati K. i E., Komuna e R., për shkak të veprës penale dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin, nga neni 215 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK.

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, të mbajtur më datën 01.08.2014, prokurori Isuf Sadiku, prokuror i Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, gjatë fjalës përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës së ngritur, duke i propozuar trupit gjykues që të akuzuarën ta shpall fajtor për kryerjen e kësaj vepre penale dhe ta dënojë sipas ligjit.

E akuzuara G. S. dhe mbrojtësi i saj, avokati E. Q., gjatë fjalës përfundimtare i kanë propozuar trupit gjykues, që e akuzuara të lirohet nga akuza.

2. Provat e administruara

Trupi gjykues gjatë shqyrtimit gjyqësor ka administruar këto prova

:

- Dëgjimin e dëshmitarëve M. S.; S. Zh.; Z. P.; M. S1.dhe B. S.;
- Leximin e deklaratës së dëshmitarit M. S.;
- Provat materiale, siç janë : Raporti i shpejt i Policisë së Kosovës; Regjistri i shfrytëzuesve të ndihmave sociale për vitin 2012 dhe 2013; Vendimi nr.553-687/11, i datës 03.11.2011; Ekstrakti nga sistematizimi i vendeve të punës dhe vendimi nr.553-00-00648/13-04, i datës 07.11.2013, si dhe
- Dëgjimin e të akuzuarës G. S..

2.1. Deklaratat e dëshmitarëve

2.1.1. Dëshmitari M. S., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar është e vërtetë se në Prokurorinë Themelore në

Gjilan, e dhënë një deklaratë më datën2013. Meqë ka kaluar kohë dhe data e saktë nuk po më kujtohet, mirëpo e di se para zgjedhjeve unë kam shkuar në Qendrën për Punë Sociale në R. për t'i marrë ndihmat. Pas kësaj ne kemi patur që ti pranojmë si ndihmë shumë prej 8.000 dinarëve para Vitit të Ri dhe është e vërtetë se me datën e lartcekur kemi qenë në fshatin K. tek e akuzuara pasi që e njëjta është shefe për dhënien e ndihmave, ndërsa unë jam përfitues i ndihmave sociale. Ditën kritike së pari kam qenë në zyrën e të akuzuarës dhe meqë ishte ditë vikendi, atëherë kam shkuar edhe tek shtëpia e saj. Është e vërtetë se kam marrë ndihmë dhe atë shumë prej 5.000 dinarë. Tek e akuzuara unë kam shkuar me veturë së bashku me bashkëshorten time dhe nuk ishte dikush tjetër me neve. Ditën kritike pasi që unë i kam marrë ndihmat kam shkuar dhe i kam takuar S. Zh.in dhe M. S.dhe meqë të njëjtit nuk kishin veturë atëherë është dashur që të njëjtit t'i dërgojë për t'i marrë ndihmat. M. i ka marrë ndihmat, ndërsa S. jo dhe nuk e di arsyen. Nuk më kujtohet saktësisht se çka më ka thënë e akuzuara, ngase ka kaluar një kohë dhe kjo ka ndodhur para zgjedhjeve të vitit 2013 ku kishte presione dhe dëshirojë të njoftojë se babai im e ka humbur marrjen e ndihmave minimale për shkak të presioneve nga Serbia dhe jo vetëm babai im, por edhe shumë fshatar të tjerë e kanë humbur një të drejtë të tillë, por pas zgjedhjeve kjo e drejtë prapë i është njohur. E akuzuara i ka thënë se duhet dikush ta vërtetojë në mënyrë që dëshmitari të mos mbetet pa ndihmë që unë kam votuar për subjektin "...", ku pas kësaj unë kam dal ngase e kam ndier vehten të ofenduar dhe e kam paraqitur rastin.

Pasi që është bërë ballafaqimin e dëshmitarit në deklaratën e dhënë me datën 27.12.2013 në Prokurorinë Themelore në Gjilan, dëshmitari ka deklaruar se është e vërtetë se e akuzuara pastaj më ka thënë : "... do ti japim tash, por ndihmën sociale nuk do ta japim po që se nuk dëshmon dikush se ke votuar për subjektin politik "...", e njëjta po ashtu më ka thënë se po që se nuk vërtetohet deri me datën 17.12.2013 se ti ke votuar për "...", nuk do ta japim ndihmën sociale dhe fëmijët do ti lejmë pa bukë. Me të dalë nga dera unë i kam thënë asaj unë do të vijë, por do të shohim se me kënd do të vijë, kur jam kthyer nga R. në shtëpi, policia kishte ardhur, meqë rastin e pata raportuar një ditë më parë. Kjo ju ka ndodh edhe qytetarëve M. S.të cilëve ju ka ndërprerë ndihma sociale i cili është i afërm i imi, i cili nuk ka të holla as me blerë miell. Dua të shtoj se në regjistër kur ma ka tërhequr vërejtjen e akuzuara se nëse nuk kam votuar për "...", mua ma ka marrë numrin personal të letërnjoftimit dhe e ka

shënuar në regjistër”. Gjithashtu, dëshmitari ka shtuar se e akuzuara më ka thënë: “se do ti lë fëmijët pa bukë” dhe kjo ka qenë arsyeja që unë kam qenë i ofenduar.

Dëshmitari, po ashtu ka deklaruar se që dy vite është duke marrë ndihmë sociale, mirëpo saktësisht nuk mund të përcaktohem ngase mund të ndodh se mund të ketë më shumë se dy vite dhe për këtë unë kam edhe vendim për ti marr ndihmat sociale. Paraprakisht ne paraqesim kërkesë ku e deklarojmë gjendjen e pasurisë, se a kem të ardhura, gjendjen familjare, pastaj vërtetimi sikur unë nuk punoj dhe bashkëshortja ime. Kjo nënkupton se paraprakisht zhvillohet një procedurë pastaj pason vendimi për ndihma sociale. Dokumentet për ndihma sociale i kam dorëzuar në Sh., sepse aty është vendi ku dorëzohen dokumentet, ndërsa zonjën e kam njohur kur kam shkuar në R., për ta pranuar ndihmën d.m.th e akuzuara nuk ka qenë punëtore-anëtare e Komisionit për të pranuar kërkesën time për ndihma. Ne i pranojmë dy kategori të ndihmave sociale njëra është ndihma e rregullt mujore ndërsa tjetra është ndihma për zahirë-për vit të ri.

Siç e ceka edhe më parë me datën 30.11.2013, unë kam shkuar në R. ku atë ditë ka qenë vikend-e shtunë dhe unë kam shkuar edhe tek shtëpia e të akuzuarës. Nuk e kam ditur se ditën e shtunë nuk punohet e as nuk e kam ditur se ku e ka shtëpinë e akuzuara, ku me këtë rast kam shkuar tek shtëpia e saj për ta lutur për të ma dhënë ndihmën. E akuzuara e mori regjistrin ku e ka shikuar të njëjtën ku mi ka dhënë të hollat e mandej kam shkuar në shtëpi. Unë e kam nënshkruar këtë regjistër kur i kam pranuar të hollat. Faktin se e akuzuara më ka thënë se duhet të votosh se fëmijët do të mbesin pa bukë ma ka thënë në zyrën kur kam shkuar për ti marrë zahirët dhe nuk e di saktësisht nëse dikush ka qenë në zyre.

2.1.2. Dëshmitari S. Zh., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se të akuzuarën e kam parë vetëm një herë, por personalisht nuk e njoh. Unë të akuzuarën e kam parë në vendin e saj të punës në Qendrën për Punë Sociale në R.. Unë nuk kam marr ndihma sociale, sepse nuk kam qenë në regjistër, ngase nuk kam qenë anëtarë i Kam dëgjuar se dikush ka ndarë të holla për zgjedhje-votime dhe unë personalisht këtë nuk e kam parë, por kam dëgjuar se këto të holla jepen në zyrën e punës dhe në shtëpinë e të akuzuarës. Shuma e të hollave që qytetarët kanë marrë nga e akuzuara ka qenë shuma prej 5.000 dinarë, e cila është e barabartë me shumën prej 45 Euro. Nuk kam qenë pjesë e

ndonjë subjekti politik dhe është e vërtetë se unë kam biseduar me M. S.in për marrjen e këtyre ndihmave sociale. I njëjti më ka thënë se i kanë qitur karburante në veturë për ti dërguar njerëzit tek te e akuzuara. Në prag të zgjedhjeve ne kemi patur kërcënime dhe të njëjtat më janë dërguar përmes telefonit fiks. Të shumtën e rasteve është lajmëruar bashkëshortja ime ku të njëjtës i kanë thënë se nëse nuk votoni për subjektin politik “...”, atëherë nuk mund ta kaloni kufirin për të shkuar në S.. Ka patur edhe kërcënime tjera por momentalisht më kujtohen vetëm këto. Nga këto kërcënime, ne jemi frikësuar dhe përveç meje, edhe disa fshatarë tjerë kanë qenë të kërcnuar në këtë mënyrë. Për këtë në serbi janë arrestuar Z. J., M. P. dhe S. J. dhe disa tjerë. Arsyeja pse unë nuk kam qenë në listë është se unë nuk kam qenë anëtar i “...”dhe këtë me siguri se e kanë ditur se nuk do të votojë për subjektin “...”. Unë me të akuzuarën jam takuar vetëm ditën kur kam shkuar për ta vërtetuar se a gjendem në listën e ndihmave sociale, ku me të njëjtën jemi në ... e cila gjendet për ballë kishës. Këto të holla janë shpërndarë pa parashtruar ndonjë kërkesë të tillë për arsye se të njëjtat të holla i janë dhënë të akuzuarës nga udhëheqësit e “...”dhe të hollat nuk e kam marrë personalisht, por një person ka mund t’i merr për 10 persona tjerë përmes letërnjoftimit.

2.1.3. Dëshmitari M. S.1, gjatë dhënies së deklaratës në Stacionin Policor në Gjilan, më datën2013,³ ka deklaruar se ka qenë i maltretuar nga ana e “...”, ku mua më kanë premtuar 30.000 Dinarë, por unë i kam marrë vetëm 5.000 Dinarë dhe këto të holla i kam marrë një shtëpi private në fshatin K.. Kjo shtëpi i takon punëtorese përgjegjëse për punë sociale në R.. Unë pasi që i kam marrë 5.000 Dinarë në emër të bashkëshortes sime V. S., unë kam kërkuar ta gjejë edhe emrin tim, por nuk kam mundur gjejë në atë regjistër. Kjo ka ndodhur një ditë para zgjedhjeve më 1 dhjetor dhe na kanë thënë se ju e dini për kënd duhet të votoni, për “...”. Na kanë premtuar se nuk do t’i ndalim ndihmat nëse votoni për “...”. Të gjitha të hollat që ne i kemi pranuar përmes llogarisë bankare kanë qenë legale, ndërsa këto të holla që i kemi marrë kanë qenë ilegale dhe ata në kanë thënë që vetëm të votojmë për “...”.

³ Trupi gjykues, pas dëgjimit të palëve dhe duke u bazuar në nenin 338 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të KPP, ka marrë aktvendim që në shqyrtimin gjyqësor të lexohet deklarata e lartcekur e dëshmitarit Momir Stojkoviç, ngase ky dëshmitar nuk ka mundur të gjendet, përkatësisht ardhja e tij në gjykatë ka qenë dukshëm e vështirësuar, për shkak se sipas konstatimit të Policisë së Kosovës, i njëjti është duke punuar në Serbi. Shih Procesverbalin e vazhdimit të shqyrtimit gjyqësor, të datës 01.08.2014.

2.1.4. Dëshmitari Z. P., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se i njëjti punon në Qendrën për Punë Sociale si zyrtar për punë juridike që nga viti 2004. Vendimet për dhënien e ndihmave sociale i merr juristi, ndërsa i nënshkruan drejtori. Në marrjen e vendimit nuk merr pjesë arkëtari. Arkëtari gjithashtu nuk merr pjesë as në përpilimin e listave të shfrytëzuesve të ndihmave sociale as të rregullta e as momentale. Është e vërtetë se në fund të vitit 2013 janë dhënë ndihma të përkohshme–zahire dimërore. Vlerat e ndihmave sociale i ka përcaktuar “Zyra për Kosovë dhe Metohi”. Ndihamat e përkohshme jepen në dorë, ndërsa ndihmat të cilat jepen mujore jepen përmes llogarisë bankare. E akuzuara nuk ka ndikim në përpilimin e listave për ndihma sociale të përkohshme. Unë nuk kam dëgjuar se këto ndihma janë dedikuar për zgjedhje dhe se këto ndihma janë dhënë gjithmonë para festave të fund vitit. Kjo Qendër për Punë Sociale e mbulon komunën e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë dhe Novobërdës.

2.1.5. Dëshmitari M. S., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se që nga viti 2007 punon si vozitës në Qendrën për Punë Sociale. Është e vërtetë se unë me G. në ... të vitit 2013 kemi qenë në P. për t’i marr të hollat për ndihma të përkohshme dhe këto të holla i kemi marrë në trezor. Dhe se unë përveç punës time si vozitës, nuk kam detyrë tjetër të shpërndarjes së parave. Në disa raste, unë vetëm kam prezantuar në zyrë ku janë ndarë ndihmat e lartcekura dhe nuk kam dëgjuar që akuzuara G. t’i ketë rekomanduar shfrytëzuesve të ndihmave sociale që të votojnë për ndonjë subjekt të caktuar politik apo për ndonjë person.

2.1.6. Dëshmitari B. S., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se që tri vite është shfrytëzues i ndihmave sociale. Unë ndihmat sociale i pranoi përmes llogarisë bankare. Përveç ndihmave sociale të rregullta, ne marrim edhe ndihma të përkohshme në fund të vitit. Ndihamat momentale-të përkohshme, ne i marrim përmes regjistrit, çka do të thotë se këto ndihma ne i marrim në dorë. Gjatë muajit ... të vitit 2013 unë kam marrë 6.000 dinarë dhe këto të holla i kam marrë në ... në R.. Mua nuk më ka sugjeruar askush që të votoj për ndonjë subjekt të caktuar politik kur i kam pranuar këto ndihma. Atë ditë kam qenë së bashku me djalin e vëllait tim dhe as djalit të vëllait tim nuk i ka thënë askush që të votoj për ndonjë subjekt politik. Ditën kritike e akuzuara i ka ndarë këto ndihma sociale dhe unë nuk kam dëgjuar as nga

shfrytëzuesit tjerë që të kenë qenë të shtyrë për të votuar për ndonjë subjekt politik.

2.2. Provat materiale

Nga Raporti i shpejtë i Policisë së Kosovës, NJHR-191/13, i datës 10.12.2013, shihet se pas intervistimit të disa dëshmitarëve janë ndërmarrë edhe veprimet tjera hetimore dhe zyrtarët policor kanë shkuar në shtëpinë e të akuzuarës, ku më pastaj me të njëjtën janë kthyer në Stacionin Policor në Gjilan. Dëshmitarët M. S. dhe S. Zh., nga fshati P., kanë deklaruar se punëtorja e Qendrës për Punë Sociale-e akuzuara G. S., ka shpërndarë para në shtëpinë e saj me qëllim që nevojtarët të cilët kanë pranuar ndihma sociale kanë qenë të detyruar që të votonin për personin e caktuar.

Nga regjistrat e shfrytëzuesve të ndihmave sociale për vitin 2012 dhe 2013, shihen emrat e personave dhe shuma e të hollave të cilët kanë marrë ndihma gjatë vitit 2012 dhe 2013, ndërsa nga ekstrakti i sistematizimit të vendeve të punës shihen detyrat dhe përgjegjësitë e vendit të punës “punëtor administrativo-financiar”.

Kurse, nga vendimi nr.553-687/11, i datës 03.11.2011 dhe nga vendimi nr.553-00-00648/13-04, i datës 07.11.2013, shihen disa shkresa të cilat i janë drejtuar Qendrës për Punë Sociale në Kamenicë.

2.3. Deklarimi i të akuzuarës

E akuzuara G. S., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor e ka mohuar kryerjen e kësaj vepre penale për të cilën akuzohet. Ka shtuar se nuk është anëtare e asnjë partie politike dhe as që ka marrë pjesë në ndonjë aktivitet politik, ndërsa ka deklaruar se nuk e njeh personin M. S., mirëpo të njëjtin vetëm e ka parë kur i ka marrë ndihmat sociale. Arsye pse po më akuzon M. S., unë mendoj se është e mundur për motive politike. Unë asnjëherë nuk kam marrë ndonjë instruksion nga ndokush për t’i udhëzuar shfrytëzuesit e ndihmave sociale që të votojnë për ndonjë subjekt politik apo për ndonjë person. Unë e kam ditur se

gjatë kohës sa i kam dhënë ndihmat sociale kanë qenë duke u mbajtur zgjedhjet në Kosovë. Më datën2013 unë nuk kam qenë në vendin e punës, ngase ka qenë ditë e shtunë, si dhe nuk është e vërtetë se unë kam punuar në shtëpinë time punë zyrtare. Është e vërtetë se kanë qenë 5-6 persona për t'i tërhequr të hollat, mirëpo nuk është e vërtetë që unë kam kërkuar nga ta që të votojnë për subjektin politik "...". Gjithashtu, nuk është e vërtetë se unë e kam kushtëzuar M. S. duke i thënë që të votojë këtë parti, ngase do të mbeteni pa bukë.

3. Elementet e veprës penale

Vepra penale dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin, është parashikuar në nenin 215 të KPRK. Sipas paragrafit 1 të këtij neni formën themelore të kësaj vepre penale e kryen "Kushdo që premtion, ofron ose jep ndonjë përfitim ose dhuratë të pamërituar ndonjë personi, me qëllim që të ndikojë atë person për të votuar, për të mos votuar, për të votuar në favor apo kundër një personi apo propozimi të caktuar ose për të hedhur një votë të pavlefshme në zgjedhje apo në referendum". Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej 1 (një) deri në 5 (pesë) vjet. Ndërsa, në paragrafin 3 të këtij neni është parashikuar se këtë vepër penale e kryen edhe "kushdo që shërben si ndërmjetësues dhe shkel paragrafin 1 të këtij neni", për të cilën është parashikuar dënim i njejtë, sikur për veprën penale nga paragrafi 1 të këtij neni, dënim me burgim prej 1 (një) deri në 5 (pesë) vjet.

4. Vlerësimi i provave

Trupi gjykues i ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se duhet ti falet besimi i plotë provave të propozuara nga Prokurori i Shtetit, siç janë : deklaratat e dëshmitarëve M. S., S. Zh. dhe M. S.1, për shkak se të njejtat janë bindëse, të qarta dhe në harmoni me njëra tjetrën. Po ashtu, këto deklarata janë në harmoni edhe me raportin e shpejtë të

Policisë së Kosovës, e cila është administruar si provë materiale gjatë shqyrtimit gjyqësor. Trupi gjykues ja falin besimin e plotë dëshmisë së këtyre dëshmitarëve, edhe për shkak të faktit dëshmitë e tyre janë kuptimplote, ndërsa ajo çka është shumë e rëndësishme për këtë çështje penale, është se dëshmitë e dëshmitarëve M. S. dhe S. Zh., në përgjithësi përputhen me deklaratat e tyre të mëparshme të dhëna në procedurën paraprake. Kjo e bënë që deklaratat e tyre të vlerësohen lartë nga ana trupit gjykues, edhe për kundër disa mospërputhjeve të vogla, të cilat sipas vlerësimit të trupit gjykues, janë të arsyeshme, për shkak se “tek njerëzit me kalimin e kohës perceptimet për faktet e caktuara mund të zbehen dhe gjërat mund edhe të harrohen” dhe është e logjikshme që njerëzve të mos i kujtohen detajet shumë të hollësishme të ngjarjeve që kanë ndodhur në të kaluarën. Ajo çka është relevante për këtë çështje penale, është se përmes këtyre provave është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se e akuzuara G. S., e ka kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Trupi gjykues pas analizimit me kujdes të të gjitha provave ka ardhur në përfundim se nuk duhet ti falet besimi deklaratës së të akuzuarës G. S., e cila e mohon kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, për shkak se deklarata e saj është në kundërshtim me dëshmitë e dëshmitarëve M. S., S. Zh. dhe M. S.1, si dhe me raportin e shpejtë të Policisë së Kosovës. Përveç kësaj, deklarata e të akuzuarës G. S., në një mënyrë është edhe kundërthënëse në vetëvete, për shkak se në njërin anëse deklaron se nuk është anëtare e asnjë partie politike dhe as që ka marrë pjesë në ndonjë aktivitet politik, kurse në anën tjetër thotë arsye pse po më akuzon M. S., janë motivet politike. Sipas një konkludimi të trupit gjykues, nëse nuk je anëtarë apo simpatizantë i ndonjë partie politike, atëherë nuk është e logjikshme dhe nuk ka arsye që ndokush të akuzon për motive politike, aq më parë kur kjo ka ndodhë në prag të zgjedhjeve në Kosovë.

Kur janë në pyetje dëshmitarët Z. P.; M. S. dhe B. S., të cilët janë propozuar nga mbrojtja për tu dëgjuar si dëshmitarë, trupi gjykues ka vlerësuar se nuk janë shumë relevante dëshmitë e tyre, për shkak se faktet të cilat i kanë rrëfyer këta dëshmitarë nuk ndërlidhen drejtpërdrejtë me veprën penale për të cilën akuzohet e akuzuara. Kur i shtohet kësaj edhe fakti se dëshmitarët Z. P. dhe M. S., janë edhe kolegë të akuzuarës, ngase punojnë së bashku në Qendrën për Punë Sociale në

R., atëherë dëshmitë e tyre mund të vlerësohen edhe si jo objektive dhe jo shumë bindëse për trupin gjykues.

Gjithashtu, edhe sa i përket provave materiale të cilat janë propozuar nga mbrojtja, siç janë : regjistri i shfrytëzuesve të ndihmave sociale për vitin 2012 dhe 2013; ekstrakti i sistematizimit të vendeve të punës; vendimi nr.553-687/11, i datës2011 dhe vendimi nr.553-00-00648/13-04, i datës2013, trupi gjykues ka vlerësuar se edhe këto prova nuk janë shumë relevante për këtë çështje penale, ngase i referohen disa fakteve rrethanore dhe jo shumë të rëndësishme për të vendosur për përgjegjësinë penale të akuzuarës.

5. Konstatimet e trupit gjykues

Andaj, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 361 të KPP, trupi gjykues e vërtetoi këtë gjendje faktike :

- se është vërtetuar se e akuzuara G. S., e ka kryer veprën penale me këtë ka kryer veprën penale dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin, nga neni 215 paragrafi 1 i KPRK.

6. Rikualifikimi ligjor i veprës penale

Sipas aktakuzës së lartcekur të Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, e akuzuara G. S., është akuzuar për shkak të veprës penale dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin, nga neni 215 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 i KPRK. Në nenin 360 paragrafi 2 të KPP, është parashikuar se “gjkata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës”. Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, trupi gjykues ka bërë rikualifikimin ligjor të veprës penale, me ç’rast të akuzuaren e ka shpallur fajtores për shkak të veprës penale dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin, nga neni 215 paragrafi 1 i KPRK, ngase ka ardhur në përfundim se veprimet e të akuzuarës i përmbajnë elementet e kësaj

forme të veprës penale. Trupi gjykues, nuk e ka aprovuar propozimin e prokurorit të shtetit që e akuzuarë të shpallet fajtor për shkak të veprës penale dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin, nga neni 215 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 i KPRK (edhe pse, siç është cekur më lartë për këto dy forma të kësaj veprë penale janë parashikuar dënime të njëjta),⁴ ngase e njëjta nuk ka shërbyer si “ndërmjetësuese”, por e njëjta në mënyrë të drejtpërdrejtë e ka kryer këtë vepër penale.

7. Vendimi për shpalljen fajtor të të akuzuarës

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, trupi gjykues e shpalli fajtor të akuzuarën G. S., për kryerjen e veprës penale dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin, nga neni 215 paragrafi 1 i KPRK, ngase veprimet e të njëjtës i përmbajnë elementet e kësaj veprë penale dhe se për të njëjtën është penalisht përgjegjëse.

8. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Duke u bazuar në nenin 73 dhe 74 të KPRK, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarës, trupi gjykues i ka marrë për bazë shumë rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarën, trupi gjykues i ka marrë për bazë sjelljet tepër të mira të të akuzuarës gjatë shqyrtimit gjyqësor; se sipas deklaratës së të akuzuarës, të cilës trupi gjykues ja fali besimin, e njëjta është e martuar dhe është nënë e dy fëmijëve; se e njëjta është një grua e cila është e shtyrë në moshë (mbi 60 vjeçare) dhe se akuzuarë më parë nuk ka qenë e dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Sipas vlerësimit të trupit gjykues, këto janë rrethana të cilat tregojnë se dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe e akuzuarë me të drejtë mund të pritet që në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale. Ndërsa, trupi gjykues nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese për të akuzuarën.

⁴ Shih pikën 3 të arsytimit të këtij aktgjykimi “Elementet e veprës penale”.

9. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarës dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së trupit gjykues, dënimi me kusht, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzurës.

Trupi gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarës nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e saj; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

10. Llogaritja e kohës së kaluar në arrest shtëpiak në dënimin e shqiptuar

Trupi gjykues, duke u bazuar në nenin 83 të KPRK, ka vendosur që nëse revokohet dënimin me kusht, atëherë në dënimin e shqiptuar me burgim, të akuzuarës G. S., do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak, prej datës 10.12.2013 deri më datën 28.01.2014.

11. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarës, trupi gjykues, duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të akuzuarën ta detyrojë për ta paguar vetëm paushallin gjyqësor.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Krimeve të Rënda

Më 15.08.2014

Sekretarja juridike,
gjkues,
Vahide Dërmaku

Kryetari i trupit

Afrim Shala

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.